



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	116/15
Nr. i fq. / Br. st	- 9 -
Data: / Datum	28.05.2015
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E IV-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,
MBAJTUR MË 30 PRILL 2015

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën **10:13**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - reagoi lidhur me publikimin e një shkrimi gazetaresk në gazetën “Zëri” ku apostrofohet edhe emri i tij si i përfshirë në procesin e fajdeve me familjen Gërbeshi, ku thuhet se kjo familje më ka dhënë një lokal, prandaj me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale deklaroi se nuk e njeh fare familjen Gërbeshi, përveç se që ka dëgjuar për të përmes medieve, dhe shtoi se nuk ka pasur asnjëherë ndonjë lokal, prandaj kjo është një shpifje kundër tij dhe familjes së tij. Në vazhdim tha se që nga paslufta është përballuar me shpifje dhe kërcënime të ndryshme, por shprehu gatishmërinë që të përballlet me drejtësi të mirëfilltë për çdo gjë. Në fund tha se lidhur me këtë shpifje ka dërguar me shkrim reagimin e tij në gazetën në fjalë, si dhe paralajmëroi se do të ndërmerret të gjitha masat ligjore kundër këtyre shpifjeve.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit- kërkoi që nga sot të bëhet ndryshimi në përbërjen e anëtarëve të KPF-së dhe të Komitetit për Komunitete, duke i larguar nga këto dy komitete Bahrije Pllanën dhe Sabri Feratin, pasi që të njëjtit nuk janë më pjesë e AAK-së, prandaj duhet të bëhet zëvendësimi i tyre.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës ka kërkuar informacione lidhur me disa kategori të shpenzimeve nga kryetari i komunës dhe të njëjtën kërkesë ia kam dërguar edhe drejtorit të DBF-së, por është

injuar përgjigja, prandaj të njëjtën kërkesë po e dorëzon në formë të vërejtjeve dhe kërkoi që të bëhet pjesë e procesverbalit, si dhe kërkoi përgjigje me shkrim për çështjet e ngritura.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - pyeti se çfarë po ndodh me shtëpinë e Mahmut Agë Gjinollit, pasi që u renovua, por ditëve të fundit është duke u shkatërruar, dhe pyeti se në interes të kujt është, pasi që investimet që janë bërë për renovimin e objektit në fjalë janë duke u shkatërruar, duke shprehur dyshimet e tij nëse objekti në fjalë me qëllim po lejohet që të dëmtohet, në mënyrë që pas një kohe të rrenohet në tërësi, prandaj për çështjen në fjalë kërkoi përgjigje nga DKRS-ja. Pastaj tha se gjendja ekonomike e Zekë Hajrizit (veteran i UÇK-së) nga fshati Stroc është shumë e rëndë dhe i njëjti ka mbetur edhe pa shtëpi, pasi që deri më tani ka banuar në shtëpinë e vëllait të vet, por me kthimin e vëllait nga bota jashtme, Zeka ka mbetur pa shtëpi, dhe që disa muaj ka kërkuar ndihmë në komunë, por deri më tani nuk ka marrë asnjë përgjigje, prandaj kërkesa e tij është që t'i sigurohet banimi dhe shtoi se në banesat kolektive në fshatin Lumadh (sipas shumë dëshmitarëve) ka banesa që nuk banon askush, sepse disa banorë kanë ndërtuar shtëpi, por ato banesa i mbajnë të uzurpuara, prandaj kërkoi sqarime lidhur me çështjen e këtyre banesave.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - kërkoi që të hiqet praktika që në ditën e mbledhjes së KK-së të sjellen pika të reja të rendit të ditës.

Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit - lidhur me rrënojat e restorantit përballë Akademisë Policore, tha se akoma kanë mbetur aty, dhe janë duke i dhënë pamje shumë të keqe qytetit, prandaj pyeti kryetarin e komunës kur do të hiqen ato rrënoja. Pastaj tha se në rrugën "Skënderbeu" kapakët e pusetave lëvizin dhe dëgjohet një zhurmë e madhe kur mbi ta kalojnë automjetet, prandaj pyeti a është bërë pranimi teknik, dhe nëse është bërë pse është bërë pranimi teknik me këtë defekt tek kapakët e pusetave.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - pyeti kryetarin e komunës se a është ndërmarrë ndonjë veprim për rregullimin e rrugëve në Stroc dhe Bivolak?

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - lidhur me ndarjen e subvencioneve për serra, kërkoi nga drejtoresha që të informohet sa i përket projektit të fituar dhe firma që ka marrë përsipër ndërtimin e serrave, duke përfshirë të gjitha shërbimet e detajuara dhe shtoi se është e pakuptimtë që nuk po përkrahen ndërtuesit (kultivuesit) e serrave nga Komuna e Vushtrrisë, por po favorizohen kultivuesit e serrave nga komunat tjera.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se është obligim i qeverisë komunale që të zbatohen prioritetet e përcaktuara sipas planit të aprovuar nga kuvendi i komunës, duke kërkuar që të mos ketë ndërhyrje nga zyrtarët e administratës në ndryshimin e drejtimit të ndërtimit të rrugëve, pasi që ka reagime të qytetarëve lidhur me këto ndryshime. Pastaj tha se në mbledhjet e mëparshme janë shqyrtuar raportet financiare dhe është thënë se janë në web-faqe, por web-faqja nuk funksionon, sepse në mbledhjen paraprake të KK-së ka kërkuar që t'ju dorëzohen me shkrim raportet financiare të komunës për vitin 2014, por nuk i kemi marrë, duke shtuar se mungojnë informatat lidhur me shpenzimet në mallra dhe shërbime, sidomos në lëmin e shpenzimeve të derivateve, shpenzimet për udhëtime zyrtare, për dreka zyrtare, borxhet e mbetura, borxhet e painkasuara sipas viteve, prandaj është obligim ligjor që edhe këto çështje të përfshihen në raportet financiare.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar pyetjeve të anëtarëve të kuvendit, u përgjigj me sa vijon: çështja e ndërrimit të anëtarëve në komitetet obligative duhet të rregulloret në formë ligjore; është vlerësuar e nevojshme që të restaurohet shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit me idenë e shndërrimit në muze të komunës, edhe pse komuna ka fituar një donacion rreth 100.000 €, por mjetet në fjalë nuk kanë mjaftuar për restaurimin e plotë, dhe personat e pandërgjegjshëm i kanë dëmtuar dyert dhe dritaret e objektit në fjalë, duke njoftuar se MKRS-ja ka ndarë mjete financiare për restaurimin e plotë të këtij objekti dhe pritet që brenda këtij viti të finalizohet në tërësi restaurimi i këtij objekti; kërkesa e Zekë Hajrizit është reale, por nevojitet respektimi i procedurave ligjore; pika shtesë të rendit të ditës gjithmonë ka pasur dhe do të ketë, por janë anëtarët e kuvendit që vendosin për to; se

shpejti do të largohen mbetjet e objektit të rrënuar përballë Akademisë Policore; për problemin e kapakëve të pushtave njoftoi se akoma nuk është bërë pranimi teknik; së shpejti do të riparohen edhe rrugët në fshatin Stroc dhe Bivolak; çdo projekt realizohet duke respektuar procedurat ligjore, por është e pamundur që të realizohen të gjitha kërkesat; asnjë projekt që është planifikuar nga kuvendi i komunës nuk mund të anashkalohej, por ankesa të qytetarëve mund të paraqiten pasi që disa projekte janë dyvjeçare e disa trevjeçare.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të PDK-së propozoi që pika nr.3 e rendit të ditës “shqyrtimi i Draft-Rregullores për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në Komunën e Vushtrrisë” të hiqet nga rendi i ditës, pasi që draft-rregullorja në fjalë është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, si dhe pritet nxjerja e udhëzimeve të reja administrative që e rregullojnë këtë fushë.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Draft-Programit trevjeçar të banimit 2015-2018 (shqyrtimi i dytë).
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndarjen e bursave dhe shpërblime për nxënës (shqyrtimi i dytë).
4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për kushtet e mbajtjes së qenve dhe maceve dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre (shqyrtimi i dytë).
5. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat vetanake dhe shpenzimet.
6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Bukosh.
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale.
8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale për ndërtimin e xhamisë në ZK Studime.
9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndryshimin e Vendimit 01 Nr. 45/14 dt.27.02.2014.
10. Shqyrtimi i Informatës për sigurinë e produkteve ushqimore.
11. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale në Komunën e Vushtrrisë.
12. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore.
13. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Dhënien e Dekorativave.
 - b. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien e titullit “Qytetar nderi” për Harald Niklasson dhe Lena Petersson.
 - c. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale.
- ç. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet me vota unanime procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Draft-Programit trevjeçar të banimit 2015-2018 (shqyrtimi i dytë).

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Programi Trevjeçar i Banimit 2015-2018.

3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndarjen e bursave dhe shpërblime për nxënës (shqyrtimi i dytë).

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - lidhur me draft-rregulloren në fjalë, paraqiti këto vërejtje dhe propozime: pyeti pse nuk iu është bashkëngjitur kësaj draft-rregulloreje proceverbali i diskutimit publik, pasi që gjatë atij diskutimi publik kishte propozime nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave të ndryshme, të cilat përkonin me propozimet e Lëvizjes Vetëvendosje. Pastaj tha se disa nga propozimet e Lëvizjes Vetëvendosje janë inkorporuar në draft-rregulloren në fjalë, por mungon propozimi kryesor, e që është ndarja në katër kategori për përfituesit e bursave: 1. Kategoria me notë të lartë mesatare, në të cilën kriter i vetëm është nota mesatare (40 % e numrit total të bursave të ndahen për këtë kategori); 2. Kategoria për fëmijët e familjeve të dëshmorëve, veteranëve, invalidëve dhe të burgosurve politikë, duke e marrë si kriter notën mesatare dhe kriteret tjera (20 % e numrit total të bursave të ndahen për këtë kategori); 3. Kategoria për drejtimet deficitare (20 % e numrit total të bursave të ndahen për këtë kategori); 4. Kategoria për rastet sociale (20 % e numrit total të bursave të ndahen për këtë kategori). Në fund tha se nëse futen propozimet e sipërpërmendura, do ta përkrahin draft-rregulloren në fjalë, në të kundërtën nuk do të votojnë “për”.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, propozoi që pikat e vlerësimit për nxënësit me suksese dhe rezultate të arritura të ngritën nga 5 në 20 pikë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - lidhur me draft-rregulloren në fjalë, propozoi që t'i shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje: “përfituesve të bursës nga viti paraprak, iu vazhdohet me automatizëm, nëse i/e njëjti ofron dëshmi të përfundimit të vitit akademik me sukses dhe me notën mesatare prej 7.5 e sipër. Për këtë kategori nuk shpallet konkurs”.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - lidhur me draft-rregulloren në fjalë, paraqiti këto propozime: kategoria e familjeve të dëshmorëve të ndahet me një nen të veçantë, si dhe bursa për këtë kategori të fillojë nga viti i parë i studimeve universitare; të futet një nen i ri për studentët që marrin bursa për drejtimet deficitare që obligohen të shërbejnë për aq vite sa marrin bursa në Komunën e Vuishttrisë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me propozimin e H.Mustafës për kushtëzimin me punë për drejtimet deficitare, tha se është e vështirë të realizohet nga komuna, duke shtuar se të njëjtit bëhen përfitues të dyfishtë edhe marrin bursën edhe sigurojnë vendin e punës, mirëpo komuna e ka obligim shpalljen e konkursit, duke iu dhënë përparësi atyre që kanë marrë bursa.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - tha se përmbajtja e ligjeve dhe akteve nënligjore janë shumë të mira, por me rëndësi është zbatimi i tyre. Në fund shtoi se drejtori e ka pagën e mirë, prandaj të mos e fut djalin e vet në listë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, 4 “kundër”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për ndarjen e bursave dhe shpërblime për nxënës, duke inkorporuar në të propozimet e anëtarëve të kuvendit të komunës, të cilat u votuan veç e veç.

4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për kushtet e mbajtjes së qenve dhe maceve dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre (shqyrtimi i dytë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për kushtet e mbajtjes së qenve dhe maceve dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre.

5. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat vetanake dhe shpenzimet.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se raporti në fjalë është i mangët, sepse i mungojnë shumë gjëra, pasi që duhet të paraqiten edhe konkludime se çka e karakterizon këtë etapë raportuese financiare tremujore për Komunën e Vushtrrisë. Pastaj tha se kemi kërkuar që të hyrat vetanake të ndahen sipas viteve për të kuptuar se sa janë të hyrat e painkasuara dhe sa janë të inkasuara sipas viteve. Po ashtu në raport mungon: paraqitja e shpenzimeve në mënyrë të detajuar, pasi që edhe për këtë etapë raportuese është e nevojshme që të paraqiten shpenzimet e sakta dhe të zbërthyer; komparacioni dhe përqindja në mes të një periudhe të caktuar dhe periudhës kur po raportohet, dhe shtoi se disa shifra të komunës sonë nuk përputhen me shifrat që janë në ministrinë përkatëse, sidomos tek pagat dhe mëditjet dhe mallrat dhe shërbimet, pasi që në komunë janë më të mëdha, kurse në ministri janë paraqitur më të vogla, prandaj është e nevojshme që të informohemi pse ekziston kjo mospërputhje. Po ashtu kërkoi sqarime në mënyrë të detajuar se sa shpenzime janë bërë për dreka zyrtare, për karburante, për mëditje, udhëtime zyrtare jashtë vendit dhe brenda vendit.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - duke iu referuar raportit në fjalë, propozoi që të formohet një grup punues nga kuvendi i komunës për ta gjetur një formë të raportimit në mënyrë që të gjithë anëtarët e kuvendit ta kuptojnë në detaje përmbajtjen e raporteve të tilla.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me vërejtjet dhe pyetjet e anëtarëve të kuvendit për raportin në fjalë.

6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Bukosh.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - duke e mbështetur propozim-vendimin në fjalë, paraqiti vërejtje për Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, pasi që kuvendi i komunës më datën 27.03.2014 ka marrë vendim për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Stroc, por drejtorja në fjalë është dashtë të dalë në terren dhe ta caktojë vendin, dhe si rezultat i moskryerjes së punëve nga kjo drejtori, në fshatin Stroc janë krijuar probleme në mes të fshatarëve, prandaj është e nevojshme që drejtorja kompetente të dalë në terren dhe të caktojë pikat për lokacionin e varrezave, në mënyrë që të shmangen problemet në mes të fshatarëve.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - tha se është e nevojshme që drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të paraqet sqarime të detajuara lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së - paraqiti sqarime plotësuese lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për varrezat në fshatin Bukosh për fshatrat: Liqej, Taraxhë dhe Bukosh, pjesë nga parcela kadastrale P-70202011400792-0 në sipërfaqe prej 10000 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 52175 m², ZK Bukosh, e cila evidentohet si pronë shoqërore e Komunës së Vushtrrisë, me nr. të parcelës 792.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim, Komuna e Vushtrrisë në pjesë nga parcela kadastrale P-70202046-00508-3 në sipërfaqe prej 65 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5857 m², ZK Maxhunaj, pronë e Komunës së Vushtrrisë, bën këmbimin e pronës së paluajtshme me pjesë nga parcela kadastrale P-70202046-00524-1, në sipërfaqe prej 65 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 335 m², ZK Maxhunaj, pronë e Ferit (Sherif) Bektshit nga fshati Maxhunaj, Komuna e Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale për ndërtimin e xhamisë në ZK Studime.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që të aprovohet propozim-vendimi në fjalë.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - tha se është bërë një vit që diskutohet për këtë çështje, prandaj kërkoi që të aprovohet propozim-vendimi në fjalë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se në bazë të informatave që ka, toka është në komasacion, prandaj nuk do të mund të ndërtohet xhami në atë lokacion.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim jepet në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme komunale – pjesë nga parcela kadastrale nr.190, fletëtreguesi nr.204 në sipërfaqe prej 900 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2571 m², ZK Studime e Poshtme, e evidentuar në emër të PSH Komisioni për Komasacion.

Paluajtshmëria e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi i jepet në shfrytëzim pa kompensim në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve për Këshillin e Bashkësisë Islame në Vushtrri për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Studime e Poshtme.

Nëse brenda afatit prej tre (3) viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi nuk fillon investimi, atëherë ndërpritet (humbet) e drejta e shfrytëzimit të parcelës sipas nenit 1 të këtij Vendimi.

9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndryshimin e Vendimit 01 Nr. 45/14 dt.27.02.2014.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim ndryshohet Neni 1, paragrafi 1, pika 4 e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.45/14 dt. 27.02.2014 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale si vijon: në vend të Tefik Malokut caktohet Bedri Dobra.

10. Shqyrtimi i Informatës për sigurinë e produkteve ushqimore.

Safet Osmani, anëtar i kuvendit - tha se informatës në fjalë i mungojnë analizat laboratorike, të cilat janë finalja, që jepin sigurinë e produkteve ushqimore, duke shtuar se në këtë informatë është vetëm një analizë laboratorike, e cila është bërë e klorit të ujit. Në vazhdim propozoi që në informatën e radhës, sidomos kur ka ndryshim të temperaturave gjatë inspektimeve të ardhshme të merren mostrat dhe të dërgohen për analiza laboratorike dhe të njëjtat të përfshihen në informatë. Po ashtu kërkoi nga Drejtoria për Inspektime të bëjnë: inspektimin e ruajtjes së produkteve ushqimore, pasi që shumica e produkteve ushqimore nuk ruhen në kushtet të cilat janë të parapara; të bëhen analizat kimike, në mënyrë që të dihet përmbajtja e lëndëve ushqyese në produktet ushqimore, për ta verifikuar se a i përmbajnë lëndët ushqyese të deklaruara në deklaracion.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - duke iu referuar problemeve teknike në rezervuarët e ujit të paraqitura në informatën në fjalë, kërkoi që të adresohet kjo problematikë tek organet përkatëse për vlerësim të saktë të gjendjes faktike në aspektin higjieno-sanitar dhe hidro-teknik, duke shtuar se nëse ndërmarrja regjionale e ujësjellësit nuk merr masat e duhura për riparime adekuate, atëherë të ngritet çështja në nivelet më të larta për rregullimin e gjendjes, siç janë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ambientit dhe Ministria e Ekonomisë, sepse ky problem është shumë shqetësues për shëndetin publik për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, dhe si dëshmi përmendi numrin e madh të qytetarëve të prekur nga tularemia.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit - kërkoi që në informatat e radhës, kjo informatë të plotësohet edhe me inspektimet e ëmbëltove dhe lokaleve shërbyese, me theks të veçantë lokalet që shërbejnë afër shkollave, pasi që heliobakteri dhe parotiti janë shumë prezent nëpër shkolla, prandaj duhet të dihet se nga po vijnë.

Gëzim Saraçi, drejtor i DI-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me pyetjet dhe vërejtjet e anëtarëve të kuvendit për informatën në fjalë.

11. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale në Komunën e Vushtrrisë.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, paraqiti shqetësimin lidhur me komisionin për çështje banesore për raste sociale, i cili është zgjedhur nga kuvendi i komunës, pasi që komisioni në fjalë ka dy ose tre muaj që nuk ka mbajtur asnjë takim, edhe pse dihet që në këtë fushë ka shumë probleme që kërkojnë zgjidhje. Në fund në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi informatë lidhur me bashkëpunimin me Komunën e Vaxjo-s të Suedisë, duke kërkuar sqarime për grupin punues që e ka përcjellur delegacionin që ka qenë në Kosovë, dhe punën që ka bërë grupi punues nga Kosova gjatë vizitës së realizuar në Komunën e Suedisë.

12. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar pikës nr.3 të informatës në fjalë, tha se Bedri Shabani dhe Gani Ajeti e kanë fituar tenderin, i cili është shpallur para tri ose katër viteve, por uzurpatorët nuk i kanë lejuar që t'i punojnë tokat, dhe për këtë arsye të njëjtat e kanë bërë pagesën e këstit të parë, por më nuk kanë vazhduar të bëjnë pagesa.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - lidhur me informatën në fjalë, tha se edhe ato prona që janë dhënë në shfrytëzim janë të uzurpuara, duke shtuar se pronat e uzurpuara kanë mbetur në mëshirën e qytetarëve, prandaj është e nevojshme që pronat të menaxhohen, dhe

ndaj atyre që kanë uzurpuar pronat të ndërmerren masat e duhura ligjore, ndërsa komuna nuk ka ndonjë interes prej këtyre pronave që janë dhënë me qira, pasi që nuk ka angazhime rreth inkasimeve dhe zbatimit të kontratave.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se iniciativa për dhënien e tokave në shfrytëzim është e qëlluar, pasi që duke i dhënë në shfrytëzim ka përfitime komuna, por në të njëjtën kohë dihet se pronar i tyre është komuna. Pastaj tha se personat që kanë fituar tenderin, është dashtë të ankohen me kohë tek komisioni përkatës komunal për problemet me të cilat janë ballafaquar në punimin e atyre tokave.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - duke iu referuar problemeve me uzurpatorët e tokave të komunës, tha se njëri prej përfituesve të shfrytëzimit të tokës është një familjar i tij, dhe rastin e kanë paraqitur tek ish-drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, por i cili nuk ka ndërmarrë asgjë.

13. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien e titullit “Qytetar nderi” për Lena Petersson dhe Harald Niklasson.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim Lena Petersson nga Komuna Vaxjo – Suedi, shpallet QYTETAR NDERI i Komunës së Vushtrrisë.

Me këtë Vendim Harald Niklasson nga Komuna Vaxjo – Suedi, shpallet QYTETAR NDERI i Komunës së Vushtrrisë.

b. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 32 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim Komuna e Vushtrrisë në pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-01094-0 në sipërfaqe prej 11 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3441 m², ZK Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, bën këmbimin e pronës së paluajtshme me pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-00152-1, në sipërfaqe prej 11 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 70 m², ZK Vushtrri, pronë e Agron (Sabedin) Hysenit nga Vushtrria.

c. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Dhënien e Dekoratave.

Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - lidhur me draft-rregulloren në fjalë, propozoi që tek çmimet e poeteshave të shtohet edhe çmimi “debutuesja”, i cili duhet të ketë vlerën prej 100 €, dhe ky çmim t’i ndahet asaj që merr pjesë për herë të parë dhe që është më e reja në moshë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Dhënien e Dekoratave, duke inkorporuar në të edhe propozimin e anëtares së kuvendit.

ç. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - lidhur më datën 1 maj, e cila është data ndërkombëtare e punëtorëve, e në të cilën protestohet për të drejtat e punëtorëve dhe kundër papunësisë, paraqiti shqetësimin për sa i përket formës së shpërndarjes së parasë së taksapaguesve për të subvencionuar manifestime që janë në shpërputhje me frymën ndërkombëtare të shënimit të kësaj date, duke shtuar se vetëm në gjashtë muajt e fundit nga komuna jonë kanë ikur me mijëra qytetarë (shumica prej tyre të rinj) për shkak të papunësisë, prandaj ku qëndron logjika e subvencionimit të këtij manifestimi.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - pyeti drejtorin e Drejtorisë për Prokurim se kur e ka shpallur tenderin çfarë çmimi kanë ofruar aplikuesit, dhe përfituesi me çfarë çmimi ka punuar për çdo pjesë të serrës, duke u shprehur kundër pse nuk është bërë ndarja në mes të ndërtuesit të serrës prej blerësit (furnizuesit) me fidane, prandaj është e nevojshme që të bëhet ndarja në fjalë. Në fund kërkoi që komisioni ta verifikojë çdo rast dhe ndaj atyre që kanë përfituar serrë përmes keqpërdorimit të merren masa.


Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - kërkoi angazhim personal të kryetarit të komunës që të mos devijohen drejtimit e ndërtimit të rrugëve sidomos në pjesën e Podranqës, pasi që në disa raste ka devijime të drejtimit të ndërtimit të rrugëve. Po ashtu kërkoi që t'i jepet prioritet rregullimit të rrugës Vesekoc – Kurillovë, për t'u krijuar mundësi për qarkullim të banorëve, si dhe të parandalohet shpërngulja e atyre banorëve.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - pyeti se a është formuar komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve lidhur me emërtimin e rrugëve dhe shesheve, duke shtuar se lagjja e tij është emërtuar me emrin e Shaban Tahirit, kurse kërkesa e tij është bërë që rrugicës së tyre t'ju vendoset emërtimi i gjyshit të tij, pasi që e tërë lagjja janë me mbiemrin Januzi.


Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar pyetjeve të anëtarëve të kuvendit, u përgjigj me sa vijon: në nivelin komunal nuk organizohet ndonjë manifestim lidhur me festën e 1 majit; e mbështeti propozimin që të bëhet ndarja në mes të ndërtuesve të pjesës së vrazhdë të serrave dhe furnizuesve me fidane; rruga për fshatin Vesekoc është planifikuar dhe është projekt trevjeçar me emërtimin Skromë – Bozhlan – Vesekoc – Kurillovë; çështjen e komisionit të kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve do ta trajtojmë me përkushtim të madh së bashku me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

Albanez Tahiraj



Procesmbajtës



Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit